



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:255412

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05513053

PPP.nr.992/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtarin Ibrahim Maloku, si dhe me bashkëpunëtorin profesional Festim Zeqiri, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Inspektorati Shëndetësor me adresë Instituti B, kati përdhese, rrethi i QKUK-së, Prishtinë, kundër debitorit E. A nga Ferizaji, rr....., duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori me datë 14.11.2022, kundër Urdhrit për lejimin e përmbartimit numër P.nr.295/2022, i datës 02.11.2022, i lejuar nga Zyra Përmbartimore e Përmbartuesi Privat Irfan I Kërçagu, i emëruar për regjionin e Prishtinës, jashtë seancës gjyqësore, me datë 27.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET SI I PA BAZUAR prapësimi i debitorit E. A nga Ferizaji, rr....., ashtu që MBETET NË FUQI urdhri për lejimin e përmbartimit numër P.nr.295/2022, i datës 02.11.2022, i lejuar nga Zyra Përmbartimore-Përmbartuesi Privat Irfan I Kërçagu në Prishtinë.

A r s y e t i m

Zyra Përmbartimore e Përmbartuesit Privat Irfan Kërçagu me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të parashtruar nga kreditori Inspektorati Shëndetësor, ka lejuar përmbartimin në bazë të Urdhrit Përmbartimor P.nr.295/2022, i datës 02.11.2022, në bazë të dokumentit përmbartimor – Vendimit të Inspektoratit Shëndetësor, Nr.10/M-110-21, i datës 22.09.2021, i plotfuqishëm nga data 16.09.2022 dhe i ekzekutueshëm nga data 16.09.2022, me të cilin Urdhër është detyruar debitori që të bëjë pagesën e gjobës në shumë prej 500 euro.

Kundër urdhërit për lejimin e përmbartimit, brenda afatit ligjor, debitori ka ushtruar prapësimin me të cilin e ka kundërshtuar përmbartimin duke theksuar se kreditori përmes vendimit të datës 22.09.2021 i ka shqiptuar gjobën prej 500 euro për shkak se kur kreditori ka bërë inspektimin tematik në qendrën e vaksinimit në kuadër të QKMF në Lipjan, ka konstatuar se debitori nuk i

është përmbajtur listës emërore të caktuar për qendrën e vaksinimit në Lipjan, listë kjo e përpiluar nga komiteti nacional i vaksinimit sipas planit të veprimit të datës 28.05.2021 me nr.prot.05-3645. Tutje ka shtuar se vendimin nr.05.691 të dt.22.09.2021 nuk e ka pranuar asnjëherë dhe nuk ka pas mundësi të ankohet pranë Inspektoratit Shëndetësor të Kosovës, ndërsa në lidhje me periudhën e vaksinimit për COVID-19 ka theksuar se ka qenë i angazhuar nga data 16.08.2021 deri me datë 15.10.2021 në Qendrën e Vaksinimit në QKMF “Dëshmorët e Lirisë” në Kaçanik kjo vërtetohet edhe nga lista emërore e Ministrisë së Shëndetësisë, andaj mbi bazën e të lartcekurave i ka propozuar gjykatës që urdhëri përmbarrim të refuzohet në tersi si i pabazuar.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, gjykata gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet.

Nga shkresat e lëndës rezulton se propozimi për përmbarrim është iniciuar duke u mbështetur në vendimin e Inspektoratit Shëndetësor me Nr.10/M-110-21 i datës 22.09.2021 përmes të cilit debitorit i është shqiptuar gjobë në vlerë prej 500€ dhe është obliguar debitori që në afat prej 8 dite ta kryej pagesën në llogarinë e Ministrisë së Shëndetësisë.

Me nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së përcaktohet se dokument përmbarrues është *“Vendimi përmbarrues i dhënë në procedurë administrative dhe akt pajtimi”*. Ndërsa dispozita nga neni 24 par.3 e LPP-së parasheh që: *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarrimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”*. Në anën tjetër, neni 27 par.1 i LPP-së përcakton elementet që duhet t’i përmbajë një dokument përmbarrimor në mënyrë që të jetë i përshtatshëm për përmbarrim. Kjo dispozitë parasheh që *“Dokumenti përmbarrimor është i përshtatshëm për përmbarrim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Referuar mënyrës se si është formuluar, rrjedh se dispozita në fjalë kërkon që elementet e renditura më sipër duhet të përmbushen në mënyrë kumulative dhe mungesa e njërit prej tyre në dokumentin përmbarrimor, rrjedhimisht ia heqë cilësinë e dokumentit të përshtatshëm për përmbarrim.

Në rastin konkret, gjykata vlerëson se vendimi Nr.10/M-110-21 i datës 22.09.2021 i lëshuar nga Inspektorati Shëndetësor, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 par 1 të LPP-së në mënyrë që të përmbarrrohet pasi që përmban të dhënat e kreditorit dhe debitorit, objektin, shumën prej 500.00€ në emër të gjobës dhe afatin 8 ditor për përmbushje vullnetare të detyrimit, dhe vulat e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë me datë 16.09.2022, nga të cilat vërtetohet se i njëjti ka marrë formë të prerë dhe është i ekzekutueshëm, rrjedhimisht gjykata vlerëson se ky vendim është i përshtatshëm për përmbarrim.

Në momentin e vendosjes gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e ngritura nga debitori dhe provat e bashkangjitura prapësimi nga të cilat rezultojnë se debitori me datën 17.09.2021 kur i është shqiptuar gjoba në shumë prej 500.00€ për mos prezencë në Qendrën e Vaksinimit në Lipjan, fare nuk ka qenë i angazhuar në Qendrën e Vaksinimit në Lipjan, mirëpo në bazë të organizimeve të kryera nga Ministria e Shëndetësisë për periudhën 16.08.2021 deri 15.10.2021, debitori ka qenë i angazhuar në Qendrën e Vaksinimit në QKMF në Kaçanik, andaj rezulton se si rezultat i lëshimeve të kreditorit ka ardh deri tek shqiptimi i kësaj gjobe ndaj debitorit. Sa i përket këtyre pretendimeve Gjykata thekson se procedura përmbarrimore është procedurë e karakterit rigoroz formal përmes të cilës bëhet realizimi i drejtpërdrejt i të drejtave të njohura

në bazë të titujve ekzekutiv në këtë rast dokumentit përmbarues - Vendimit të Inspektoratit Shëndetësor Nr.10/M-110-21 i datës 22.09.2021, i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm që nga data 16.09.2022, dhe në këtë procedurë përmbarimore përjashtohet mundësia e shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimit mbi bazën e të cilit është iniciuar procedura përmbarimor për shkak me ligje të veçanta janë përcaktuar mekanizmat ligjor të cilët debitori i ka patur në dispozicion dhe ka mundur ti shfrytëzoj e përmes të cilave do të kishte patur mundësi që të godas në pikëpamje të ligjshmërisë vendimin mbi bazën e të cilit është iniciuar kjo procedurë përmbarimore.

Bazuar në këto arsye, meqë Urdhëri Përmbarimor është lejuar mbi bazën e një dokumenti i cili është i përshtatshëm për përmbarim, Gjykata konstatoi se prapësimi i ushtruar nga debitori nuk gjen mbështetje në dispozitën e nenit 71 par.1 pika 1.1 deri 1.12 të LPP-së, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke e refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi në bazë të nenit 73 paragrafi 3 i Ligjit të Procedurës Përmbarimore.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
PPP.nr.992/2022, dt.27.03.2024

Gjyqtari,
Ibrahim Maloku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë